Kronika

Shkodër/ Tritol agjencisë funerale, vetëm dëme materiale! Nisin hetimet, ja pista ku dyshohet dhe pasojat e shpërthimit (VIDEO dhe FOTO)

Ngjarja rreth orës 03:20 të mëngjesit të sotëm. Po verifikohen dhe pamjet filmike të kamerave të sigurisë në zonë. Pista e parë e hetimit, konkurrenca. Ja pasojat e shpërthimit

■ VIDEO/ Ja pasojat që la shpërthimi i tritolit në agjencinë funerale: Dera e shkatërruar, një gropë në dysheme dhe materiale të dëmtuara

Lajmi i fundit

Ambasadori gjerman 'zhvishet' nga kostumi i diplomatit, ndan pamjet duke përgatitur fli në saç në Kosovë (VIDEO)

29 Gusht, 10:38

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sh.COM **Redaksia**
29 Gusht, 07:09 | **Përditesimi: 29 Gusht, 09:05**

Share

Shkodër- Një sasi eksplozivi shpërtheu mëngjesin e sotëm (29 Gusht) në qytetin e Shkodrës.

Objektivi ishte një **agjenci funerale** e cila sapo ishte hapur, teksa nuk u regjistruan viktima apo të lënduar, por vetëm dëme materiale. Lënda plasëse ishte vendosur në derën e subjektit që kujdeset për procesionet mortore.

Shpërthimi sipas policisë vendore u dëgjua rreth orës 03:20, kurse agjencia është në pronësi të **Flora Firza**, e cila gjithashtu po merret në pyetje për dyshimet që ka.

Sh.COM

LEXO EDHE:
Situata nga zjarret! Ministria e Mbrojtjes: 10 vatra ende aktive, nga 29 të raportuara 19 janë shuar

Persona të paidentifikuar dyshohet se janë afruar të maskuar duke vendosur tritolin dhe më pas janë larguar me shpejtësi. "Shqiptarja.com' dhe "Report TV" kanë siguruar edhe pamjet e pasojave të këtij shpërthimi, ku dallohen qartë dera e shkatërruar, një gropë në dysheme dhe materiale të dëmtuara.

Pista e parë e hetimit mbetet ajo e konkurrencës, teksa Policia ndodhet në vendngjarje për shoqërime, mbledhje provash dhe dëshmish, si dhe ndjekjen dhe kapjen e autorëve të krimit.

> *"Rreth orës 03:20, në lagjen "Skenderbeg", në derën e një agjencie funerale në pronësi të shtetasex F. F., (Flora Firza) është hedhur një sasi e vogël lëndë plasëse. Si pasojë ka vetëm dëme materiale.*
>
> *Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë vijon veprimet për sigurimin e provave me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit/ve", thuhet në njoftimin zyrtar paraprak të policisë.*

Grupi hetimor dhe prokurori i gatshëm po kërkojnë edhe për pamje të kamerave të sigurisë në zonën ku ndodhi shpërthimi.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 08:46

VIDEO/ Ja pasojat që la shpërthimi i tritolit në agjencinë funerale: Dera e shkatërruar, një gropë në dysheme dhe materiale të dëmtuara

Këto që shihni në pamje janë dëmet e shkaktuara nga shpërthimi i fuqishëm i eksplozivit, në derën e agjencisë funerale në qytetin e Shkodrës.

Ngjarja ndodhi rreth orës 03:20 të mëngjesit të sotëm në lagjen "Skënderbeg", kurse subjekti rezulton se është në pronësi të **Flora Firza**.

Sipas policisë vendore, autorët, ende të paidentifikuar, kanë vendosur një sasi të vogël tritoli në derën hyrëse të agjencisë (pesha ende e papërcaktuar nga ekspertët), bazuar te hetime paraprake dhe këqyrja e vendngjarjes.

Dëmet janë në materiale dhe pamjet në video të dërguara nga gazetari Ergys Kavaja, tregojnë vatrën e shpërthimit, dera e shkatërruar plotësisht, çarja e dyshemesë me një gropë në mes, vendi i nxirë përeth nga gjurma shpërthyese e TNT-së dhe sende materiale të dëmtuara afër zonës së shpërthimit.

Për fat të mirë nuk ka të lënduar, pasi në momentin e shpërthimit në subjekt nuk ndodhej askush.

Policia ka nisur hetimet me verifikimin e pamjeve të kamerave të sigurisë, pyetjen e pronares dhe dëshmitarëve, teksa pista kryesore mbetet konkurrenca në biznes, pa përjashtuar edhe hipotezat e tjera të mundshme kriminalistike. Hetimet janë ende aktive sipas policisë lokale.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Flora firza | agjenci funerale | tritol | Shkodër

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Skandali me mbetjet toksike, sipas jush e kujt është përgjegjësia?

Kurum | Koncesionari | Shteti

Lajme të tjera

Atentati i dështuar në Shkodër, zbulohet identiteti i dy vëllezërve Prendi! Në kërkim edhe kushëriri e tyre
28 Gusht, 16:21



Situata me zjarret, Ministria e Mbrojtjes: 7 vatra ende aktive! 23 të raportuara në 24 orë
26 Gusht, 11:16

Qyteti Evropian i Sportit, Shkodra paraqet kandidaturën për 2025! Zv/kryetari i bashkisë: Ndikon në ekonomi dhe turizëm
27 Gusht, 16:29

Zjarret në vend, Ministria e Mbrojtjes: 5 vatra zjarri vijojnë të jenë aktive! Në 24 orë u shuan 43
27 Gusht, 11:03

Lumi i Shalës fut në sherr konkurrence 2 familje në Vaun e Dejës, nën akuzë babë dhe bir! Kanosën me armë pneumatike 58-vjeçarin, shkak biznesi i varkave shëtitëse
26 Gusht, 11:45

Shkodër, Tifozat e Tiranës hedhin kapsolla në fushë pas goltë të Vllaznisë e përplasën me policinë! 4 në pranga 1 në kërkim
26 Gusht, 07:35

Muriqan/ Po udhëtonte drejt Malit të Zi me hashash në makinë, nën akuzë 25-vjeçarja kosovare
25 Gusht, 12:42

Fushë Arrëz/ Po bëntë punime në rrjetin elektrik, rrëzohet shtylla dhe bie 54- vjeçari
24 Gusht, 16:04

Atentat i dështuar në Bushat të Vaut të Dejës! Qëllohet me breshëri kallashnikovi ndaj 'Audit' të blinduar, në kërkim vëllezërit Prendi e një tjetër

Ergys Kavaja

24 Gusht, 11:29

Shkodër/ Asgjësohen 361 bimë kanabis, vihet në pranga 67-vjeçari! Ja momenti kur kapet në flagrancë (VIDEO)
24 Gusht, 10:31

Bushat/ Qëllohet me armë drejt një 'Audi', dyshohet se ka pasur shkëmbim zjarri nga dy makina! Gjenden 10 gëzhoja! S'ka të lënduar
23 Gusht, 20:08

FOTOT/ Ja si do të duket zona e Zdrales në Shkodër pas transformimit! Tenderi 275 milionë lekë, pritet nisja e punimeve
23 Gusht, 12:52

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje